



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, neneve 9,17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, nenit 10 paragrafët 10.2 dhe 10.3 të Ligjit Nr.02/L-26 për token bujqësore si dhe nenit 8 paragrafit 8.4 dhe nenit 9 të Udhëzimit administrativ nr.41/2006 për ndërrimin e tokës bujqësore , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2021 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDËRRIMIN E
DESTINIMIT TË TOKËS 15NR.320-61046 I DATËS 28.09.2018

Neni 1

Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 5 i Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018 dhe riformulohet si vijon:

“Obligohet investitori që obligimet që rrjedhin për implementimin e Projektit të tij konform dispozitave të Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndërrimin e destinimit të tokës ti kryej më së largu me datë 31.12.2021 “.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e neneve 9,17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, nenit 10 paragrafët 10.2 dhe 10.3 të Ligjit Nr.02/L-26 për token bujqësore si dhe nenit 8 paragrafit 8.4 dhe nenit 9 të Udhëzimit administrativ nr.41/2006 për ndërrimin e tokës bujqësore.

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ju ka drejtuar me shkresë zyrës së Kryetarit të Komunës përkitazi me kërkesën e Florim Feratit përfaqësues i Qendrës për trajtimin e kafshëve i cili ka kërkuar nga DPUMM afat shtesë për kompletimin e dokumentacionit për shkak se nuk ka mundur ta kompletojë dokumentacionin për ndërtimin e objektit Qendra për trajtimin e kafshëve në parcelën kadastrale P-71409001-00439-0 ZK Hanroc për shkak të gjendjes jo të zakonshme të krijuar nga pandemia Covid-19 .

Me qenë se afati dy vjeçar për implementimin e Vendimit ka skaduar, DPUMM ka dërguar lëndën në kompetencë të Zyra e Kryetarit të Komunës për shqyrtim për procesin e mëtutjeshëm të zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Komunës ose shfuqizimit të tij.

Nga të cekurat më lartë duke pasur parasysh edhe situatën e krijuar me pandeminë cila nuk ka mundur të parashikohet, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 320-552

Lipjan, më 06.01 2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

